



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË

Bordi i Entit Rregullator të Energjisë, në mbledhjen e tij të datës 13.12.2021, mori në shqyrtim praktikat e përgatitura nga drejtoritë teknike të ERE-s, dhe u shpreh si më poshtë:

1. Mbi përcaktimin e çmimit të shitjes së energjisë elektrike nga furnizuesi i mundësisë së fundit për muajin Nëntor 2021.
2. Mbi fillimin e procedurave për disa shtesa dhe ndryshime në “Rregulloren për Lidhjet e Reja në Sistemin e Shpërndarjes”, miratuar me vendimin nr. 166, datë 10.10.2016, të bordit të ERE, e ndryshuar me vendimin nr. 177, datë 08.11.2016, të bordit të ERE.
3. Mbi rishikimin e vendimit nr. 110, datë 26.04.2021, “Mbi kërkesën e shoqërisë “Biopower Green Energy” sh.p.k., për rishikimin e vendimit nr. 35, datë 04.02.2021, “Mbi kërkesën e shoqërisë “Biopower Green Energy” sh.p.k., për shtyrjen e afateve të vendimit nr. 90, datë 06.08.2008, i ndryshuar”.
4. Mbi rishikimin e vendimit nr. 111, datë 26.04.2021, “Mbi kërkesën e shoqërisë “E-Vento s.r.l. Albania” sh.p.k., për rishikimin e vendimit nr. 32, datë 04.02.2021, “Mbi kërkesën e shoqërisë “E-Vento s.r.l. Albania” sh.p.k., për shtyrjen e afateve të vendimit nr. 84, datë 17.07.2008, i ndryshuar”.
5. Mbi rishikimin e vendimit nr. 112, datë 26.04.2021, “Mbi kërkesën e shoqërisë “Hera” sh.p.k., për rishikimin e vendimit nr. 34, datë 04.02.2021, “Mbi kërkesën e shoqërisë “Hera” sh.p.k., për shtyrjen e afateve të vendimit nr. 61, datë 02.11.2007, i ndryshuar”.
6. Mbi kërkesën e shoqërisë “Kalisi Hydropower” sh.p.k., për dhënien e autorizimit nga ERE për transferimin e kuotave (nëpërmjet shitblerjes) të shoqërisë “Kalisi Hydropower” sh.p.k., ndërmjet ortakëve ekzistues të shoqërisë.